



Prishtinë: 10.12.2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1334\_2020

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2100\_09\_20**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **06.11.2020**.

### në seancën e mbajtur më datë 10.12.2020 nxori këtë:

#### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin D.C.M. (parashtruesi P.N.) nga Komuna e Gjakovës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK\_V\_2100\_09\_20 i datës 29.09.2020.

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 06.11.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-s, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë, ndaj konsumatorit D.C.M. (parashtruesi P.N.) nga Komuna e Gjakovës lidhur me kundërshtimin e borxhit të energjisë elektrike sipas kontratës së shitblerjes. Në ankesë theksohet se ekziston kontrata e shitblerjes së lokalit afarist mes Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe blerësin P.N. Në ankesë theksohet bazuar në Ligjin për Agjencisë Kosovare të Privatizimit, përkatësisht neni 37, paragrafi 9, nënparagrafi 9.3.3 theksohet se: “shumat e detyruara në fjalë nuk kanë rrjedhur përmes caktimit apo transferimeve tjera si rezultati transaksionet që është bërë brenda periudhës tre (3) muajve menjëherë pas datës së Vendimit për Likuidim”. Gjithashtu në ankesë theksohet pas përmbushjes së detyrimeve financiare, KESCO do të procedon më tutje rastin në fjalë. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2100\_09\_20, i datës 29.09.2020, për konsumatorin D.C.M. (parashtruesi P.N.) me shifër DGJ - 9007171.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.12.2020 ka analizuar të gjitha shesat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO se ekziston kontrata e shitblerjes së lokalit afarist mes Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe blerësin P.N. Bordi i ZRRE-së thekson se është plotësisht e saktë që parashtruesi i ankesës, i ka siguruar ZRRE Kontratën e shitblerjes të datës 24.12.2013 mes Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me blerësin P.N. për shitjen e lokalit afarist me etazh me



sipërfaqe 88 m<sup>2</sup> neto sipas matjeve (100 m<sup>2</sup> sipas faturës së tatimit në pronë). Pra në këtë aspekt Bordi i ZRRE nuk ka vërejtur asgjë kontestuese.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO se bazuar në Ligjin për Agjencisë Kosovare të Privatizimit, përkatësisht neni 37, paragrafi 9, nënparagrafi 9.3.3 theksohet se: “shumat e detyruara në fjalë nuk kanë rrjedhur përmes caktimit apo transferimeve tjera si rezultati transaksionet që është bërë brenda periudhës tre (3) muajve menjëherë pas datës së Vendimit për Likuidim”, Bordi i ZRRE thekson se në shkresën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me nr.15615-2014 të datës 07.10.2014, theksohet se AKP në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-034 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit e ka vendosur në likuidim ndërmarrjen Shoqërore Agimi – Mishi në Gjakovë. Në shkresë theksohet se me datë 13.08.2013 AKP ka shpallur shitjen e asetëve në Likuidim nr.21, data e ofertimit ka qenë 10.09.2013 dhe se AKP ka shpallur P.N. si fitues të përkohshëm. AKP me datë 16.12.2013 ka dorëzuar kontratën e shitblerjes P.N. me nr.7518. Gjithashtu në shkresë theksohet se me pranimin e kontratës ju është bartur shitorja e blerë por jo edhe obligimet që ajo shitore ka pasur ndaj ndërmarrjeve publike (KEDS, KUR radoniqi, KRM Qabrati etj), Tatimi në pronë apo ndaj ndonjë kreditori tjetër. Në shkresë AKP ka theksuar se obligimet e mbetura do të jenë subjekt i shqyrtimit nga Autoriteti i Likuidimit i NSH Agimi Mishi. Pra Bordi i ZRRE thekson se vet Agjencioni Kosovar i Privatizimit ka konstatuar se me pranimin e kontratës për shitjen dhe blerjen e pronës ju është bartur shitorja e blerë por jo edhe obligimet që ajo shitore ka pasur ndaj ndërmarrjeve publike (KEDS, KUR radoniqi, KRM Qabrati etj), Tatimi në pronë apo ndaj ndonjë kreditori tjetër. Andaj Bordi i ZRRE thekson në këtë kuptim edhe organi i shkallës së parë në ZRRE (DMK në ZRRE) ka marrë vendim.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO se pas përmbushjes së detyrimeve financiare, KESCO do të procedon më tutje rastin në fjalë, Bordi i ZRRE thekson se ashtu siç u potencua edhe më lartë sipas vet Agjencionit Kosovar të Privatizimit është konstatuar se me pranimin e kontratës për shitjen dhe blerjen e pronës ju është bartur shitorja e blerë, por jo edhe obligimet që ajo shitore ka pasur ndaj ndërmarrjeve publike (KEDS, KUR radoniqi, KRM Qabrati etj), Tatimi në pronë apo ndaj ndonjë kreditori tjetër. Andaj edhe vendimi i organit të shkallës së parë të ZRRE, ku është kërkuar nga KEDS/KESCO që të shkarkoi shifrën e konsumatorit **DGJ - 9007171** nga borxhi i energjisë elektrike deri në periudhën kohore 12/2013 në vlerë financiare prej 636.00€ dhe se borxhin e krijuar në këtë pikë matëse për periudhën e lartëcekur ta kërkoj përmes procedurave ligjore, është plotësisht i saktë dhe i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE gjithashtu thekson se në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, theksohet se: “konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”. Gjithashtu neni 5 paragrafi 2 nënparagrafi 2.4 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: “furnizuesi duhet të faturojë dhe të arkëtojë (mbledh) pagesat prej konsumatorëve”. Pra duhet theksuar se në atë periudhë KEK e më vonë edhe KEDS nuk kanë vepruar konform kësaj dispozite pasi që nuk kanë arrit të inkasojnë borxhin e krijuar ashtu siç përcaktohet me këtë rregull.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 10.12.2020 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.



**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit D.C.M. (parashtruesi P.N.) dhe
- Arkivit të ZRRE-së.